



REPUBLIKA E KOSOVËS
ZYRA E AUDITORIT TË PERGJITHSHEM

Nr. dokumentit : 21.3.1-2011-08

RAPORTI I AUDITIMIT
PËR PASQYRAT VJETORE FINANCIARE TË MINISTRISË SË
TREGTISË DHE INDUSTRIË PËR VITIN E PËRFUNDUAR ME
31 DHJETOR 2011

Prishtinë, Qershor 2012

TABELA E PËRMBAJTJES

Lista e shkurtesave.....	3
Përmbledhje e përgjithshme.....	4
1 Hyrje.....	5
2 Opinioni i auditimit.....	7
3 Gjendja e rekomandimeve të vitit të kaluar.....	7
4 Rezultati financiar në krahasim me buxhetin e aprovuar.....	8
5 Pasqyrat vjetore financiare – Pajtueshmëri me kornizën raportuese dhe cilësinë e informacionit.....	10
6 Menaxhimi financiar.....	11
6.1 Të hyrat (duke përfshirë ato vetjake).....	11
6.2 Shpenzimet.....	13
6.3 Pasuritë.....	17
6.4 Raportimi aktual dhe afatet kohore për procesin e përgjithshëm buxhetor.....	19
7 Kontrolli menaxherial.....	20
7.1 Sistemet e kontrollit të brendshëm.....	20
7.2 Auditimi i brendshëm.....	21
8 Një konkluzion i përgjithshëm mbi menaxhmentin e MTI-së.....	22
Shtojca I. Llojet e ndryshme të Opinioneve të Auditimit.....	23
Shtojca II: Rekomandimet e vitit të mëhershëm.....	25
Shtojca III. Komentet e MTI-së dhe përgjigjja e ZAP-it.....	28

Lista e shkurtesave

LMFPP	Ligjin nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë
LPP	Ligji për Prokurimin Publik nr.03/L-241 i ndryshuar me Ligjin nr. 04/L-042 në fuqi prej 05.10.2011
LSHCRK	Ligji për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës
MTI	Ministria e Tregtisë dhe Industrisë
MF	Ministria e Financave
NJAB	Njësia e Auditimit të Brendshëm
ONISA	Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve Supreme të Auditimit
PVF	Pasqyrat Vjetore Financiare
PV	Plani i Veprimit
KPMSHCK	Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës
SNA	Standardet Ndërkombëtare të Auditimit
SNKSP	Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik
SNISA	Standardet Nderkombetare të Institucioneve Supreme të Auditimit
SIMFK	Sistemi Informativ për Menaxhimin e Financave të Kosovës
UA	Udhëzimi Administrativ
ZAP	Zyra e Auditorit të Përgjithshëm

Përmbledhje e përgjithshme

Zyra e Auditorit të Përgjithshëm (ZAP) ka kryer auditimin e Pasqyrave Vjetore Financiare (PVF) të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë (MTI) për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2011.

Auditimi ynë është kryer në pajtim me standardet ndërkombëtare të auditimit (SNA), të hartuara nga ONISA (INTOSAI) dhe ka përfshirë testimet dhe procedurat që ne menduam se ishin të nevojshme për të dhënë një opinion lidhur me pasqyrat financiare.

Sipas opinionit tonë pasqyrat vjetore financiare *prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë* në të gjitha aspektet materiale (**SNISA 400 Opinion i Pakualifikuar**)

Gjatë vitit 2011, MTI kishte bërë progres lidhur me adresimin e rekomandimeve nga auditimi i vitit të kaluar duke kontribuar për një menaxhim më të mirë në fusha të caktuara. Kjo ka të bëjë sidomos me atë rreth regjistrimit të të hyrave sipas kodeve adekuate, zbatimin e vendimeve të nxjerra nga Komisioni i Pavarur Mbikëqyrës, përmirësime sa i përket regjistrimit të pasurive dhe forcimit të mëtutjeshëm të NJAB.

Megjithatë auditimi ynë ka identifikuar akoma mangësi në disa fusha të menaxhimit financiar të cilat duhet të adresohen nga menaxhmenti në mënyrë që të përmirësohet performanca administrative dhe financiare e Ministrisë.

Këto kanë të bëjnë sidomos me mbikëqyrjen e realizimit të projekteve kapitale, që nuk ishin bërë në pajtim të plotë me kornizën e aplikueshme ligjore dhe dhënien e licencave.

Për këtë, konkluzioni ynë i përgjithshëm është se kontrollet e përgjithshme, nuk kanë funksionuar siç duhet për të ofruar siguri që aktivitetet operative dhe menaxhimi financiar funksionojnë në pajtim me objektivat e vendosura të MTI-së.

Duke u bazuar në këto mangësi konkluzioni ynë i përgjithshëm është se nevojiten masa shtesë nga menaxhmenti i MTI-së për përmirësimin e sistemit të kontrollit të brendshëm.

Andaj ne rekomandojmë Ministrin që të siguroj:

- Prezantimin dhe shpalosjen e të dhënave në PVF në pajtueshmëri të plotë me standardet dhe kërkesat ligjore;
- Planifikim dhe shfrytëzim efektiv dhe efikas të buxhetit;
- Dhënien e licencave subjekteve afariste në pajtueshmëri me legjislacionin përkatës;

- Forcimin e kontrollit për mbikëqyrjen e projekteve afatgjata;
- Respektimin e afateve në pajtueshmëri me ligjin e shërbimit civil për emërimin e U.D për drejtorat e departamenteve; dhe
- Funksionalizimin e pasurive që janë në kuadër të MTI-së dhe menaxhimin e tyre në mënyrë efikase.

Bazuar në mangësitë e identifikuara në konstatohet se nevojitet të merren masa shtesë për përmirësimin e kontrollit të brendshëm në kuadër të ministrisë. Një mjet i mirë për t'u përdorur në lidhje me këtë është korniza Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli, për vetë-vlerësim, e nxjerrë nga Ministria e Financave.

Menaxhmentit të MTI-së i është dhënë mundësia për të bërë komente në draftin e këtij raporti.

Çështjet e papërfunduara, për të cilat ne si auditorë dhe entiteti i audituar ende kemi pikëpamje të ndryshme, mund të gjeni në Shtojcën 2.

Menaxhmenti është zotuar që do t'i bëjë të gjitha përpjekjet për të adresuar të gjitha rekomandimet e dhëna.

1 Hyrje

Ky auditim ka të bëjë me PVF të MTI-së për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2011.

Është përgjegjësi e MTI-së të përgatisë PVF sipas kërkesave të Rregullës financiare nr. 07/2011 dhe në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik (SNKSP) për "Raportimin financiar në bazë të kontabilitetit të parasë së gatshme".

ZAP është përgjegjëse për kryerjen e auditimeve vjetore të rregullsisë, në institucionin tuaj.

Auditimi i rregullsisë përkufizohet si një verifikim i kontabilitetit financiar, duke përfshirë ekzaminimin dhe vlerësimin e pasqyrave financiare dhe të dhënave tjera financiare si dhe dhënien e mendimeve:

- Nëse pasqyrat financiare japin një pamje të drejtë dhe të vërtetë të llogarive dhe çështjeve financiare për periudhën e auditimit;
- Nëse të dhënat financiare, sistemet dhe transaksionet janë në pajtim me ligjet dhe rregulloret në fuqi;

-
- Për përshtatshmërinë e funksioneve të kontrollit të brendshëm dhe të auditimit të brendshëm; dhe
 - Për të gjitha çështjet të cilat dalin apo kanë të bëjnë me auditimin.

Gjatë vitit aktual (2011) ne kemi kryer një auditim të përkohshëm në institucionin tuaj, duke trajtuar rekomandimet e mëparshme si dhe adresimin e çështjeve të menaxhimit financiar gjatë vitit aktual. Kemi këshilluar menaxhmetin për adresimin e çështjeve në pasqyra financiare, përmes memorandumit të auditimit të dorëzuar në dhjetor 2011. Ne nuk kemi prezantuar në këtë raport projektin që sipas MTI-se ishte në procedure hetimore nga autoritet relevante.

Me qëllim të përmbushjes së përgjegjësiave tona për auditimin e MTI-së, ne kemi ndërmarrë aktivitetet si në vijim:

- Kemi rishikuar PVF të MTI-së në raportë me buxhetin e miratuar për vitin 2011;
- Kemi përcaktuar nëse PVF të MTI-së janë përgatitur në pajtim me SNKSP "Raportimi Financiar në bazë të Kontabilitetit të Parasë së Gatshme";
- Kemi përcaktuar nivelet e materialitetit të të hyrave dhe shpenzimeve, si prag për lehtësimin e përcaktimit të llojit të opinionit që duhet dhënë mbi pasqyrat financiare;
- Kemi zbatuar një kombinim të mostrimit sipas gjykimit dhe sipas rastit, në përzgjedhjen e transaksioneve për testim;
- Kemi kryer testime substanciale gjithëpërfshirëse mbi transaksionet financiare;
- Jemi mbështetur në një lloj kombinimi të intervistave, rishikimeve analitike, rishikimin e dokumenteve dhe verifikimin fizik për të vlerësuar vlefshmërinë dhe rregullsinë e transaksioneve financiare; dhe
- Kemi vlerësuar cilësinë e punës së Njesisë së Auditimit të Brendshëm (NJAB) në MTI

Në këtë raport ne kemi përmbledhur auditimin e këtij viti dhe japim një opinion formal mbi PVF për vitin 2011.

Lidhur me opinionin tonë të auditimit për PVF të MTI-së, SNA përcaktojnë kriteret specifike të cilat rregullojnë llojin e opinionit që mund të jepet.

2 Opinioni i auditimit

Sipas opinionit tonë pasqyrat vjetore financiare *prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë* në të gjitha aspektet materiale (**SNISA 400 Opinion i Pakualifikuar**)

3 Gjendja e rekomandimeve të vitit të kaluar

Për Pasqyrat Vjetore Financiare të vitit 2010, MTI-së i ishte dhënë një opinion i pakualifikuar me theksim të çështjes. Theksimi i ishte dhënë për faktin se informacionet e shpalosura për pasuritë dhe të hyrave nuk ishin të plota.

Raporti jonë i auditimit i PVF-ve për vitin 2010 ka rezultuar me nëntë rekomandime kyçe.

MTI kishte përgatitur Planin e Veprimit për adresimin e rekomandimeve të dhëna duke theksuar se të gjitha rekomandimet do të adresohen.

Pavarësisht kësaj, deri në fund të auditimit tonë, dy (2) ishin adresuar plotësisht, tri (3) ishin adresuar pjesërisht dhe katër (4) nuk ishin adresuar akoma.

Për një përshkrim më të hollësishëm të rekomandimeve dhe mënyrën se si janë adresuar ato, shihni shtojcën 2.

Konkluzion

Ne konkludojmë se menaxhmenti i Ministrisë edhe përkundër angazhimit të bërë për adresimin e rekomandimeve, ende nuk kishte arritur që të vendosë fokus të mjaftueshëm për adresimin e tërësishëm të rekomandimeve që janë dhënë më parë.

Rekomandimi 1

Ne rekomandojmë Ministren e MTI-së të siguroj:

- Adresimin e plotë të rekomandimeve tona cilat do t'ju mundësojnë krijimin e parakushteve të nevojshme për menaxhimin efektiv të Ministrisë.

4 Rezultati financiar në krahasim me buxhetin e aprovuar

Analiza e Rezultatit në Pasqyrat Financiare kundrejt Buxhetit të Aprovuar tregon:

Tabela 1 Burimet e fondeve buxhetore – aktualit ndaj buxhetit (në €)

Burimi i fondeve buxhetore	Buxheti Fillestar 2011	Buxheti Final 2011	Buxheti i shpenzuar 2011	Buxheti i shpenzuar 2010
Gjithsej:	7,248,042	8,310,330	6,733,402	8,992,413
Grandi i Qeverisë – Buxheti	7,248,042	7,220,635	5,778,770	8,069,734
Donacionet e jashtme		1,059,695	946,399	922,679
Të hyrat vetjake		30,000	8,233	-

Buxheti fillestar i aprovuar nga Kuvendi ishte në vlerë prej 7,248,042€. Buxheti final ishte në shumë prej 8,310,330€. Në rritje të buxhetit final ka ndikuar donacioni i ndarë nga Banka Botërore si dhe e drejta për të shfrytëzuar të hyrat vetanake ka ngritur buxhetin final.

Tabela 2: Shpenzimi i fondeve sipas kategorive ekonomike – aktualit ndaj buxhetit (në €)

Burimet e fondeve sipas kategorive ekonomike	Buxheti Fillestar 2011	Buxheti Final 2011	Buxheti i shpenzuar 2011	Buxheti i shpenzuar 2010
Gjithsej:	7,248,042	8,310,330	6,733,402	8,992,413
Paga dhe mëditje	955,955	1,022,122	953,599	748,812
Mallra dhe shërbime	863,619	2,078,513	1,843,587	2,421,863
Shpenzimet komunale	85,680	31,675	31,136	30,556
Subvencione dhe transfere	-	-	-	324,267
Investime Kapitale	5,342,788	5,178,020	3,905,080	5,466,915

Për vitin 2011 buxheti final ishte 8,310,330€, ndërsa shpenzimet e përgjithshme ishin 6,733,402€ ose 81% e planit..

Arsyeja pse 19% e buxhetit final nuk ishte shpenzuar ka të bëjë me mosrealizimin e disa projekteve kapitale, për shkak të problemeve pronësore dhe kontrollit të dobët gjatë mbikëqyrjes së projekteve për investime kapitale.

Përveç rritjes së buxhetit në total, ndryshime kishte edhe brenda vetë kategorive ekonomike. Derisa buxheti final për paga mëditje dhe mallra shërbime ishte rritur, për investime kapitale dhe komunali ishte zvogëluar. Veç tjerash, fondi për kuadro ishte rritur për 36,000€ ndërsa investimet kapitale ishin zvogëluar për 164,768€.

Vlera e shpenzimeve në tremujorin e fundit për vitin 2011 ishte 1,992,774€ ose në masën 49% nga vlera e përgjithshme shpenzimeve prej kategorisë së investimeve kapitale. Implementimi i ulët i buxhetit gjatë nëntëmuajorit, ka rezultuar me rritjen e shpenzimeve në tremujorin e fundit të vitit financiar.

Tabela 3 Pranimet e mbledhura nga MTI (në €)

Përshkrimi	2011 Realizimi	2010 Realizimi
Të hyrat vetanake gjithsej	3,385,307	2,671,392

Konkluzioni

Ne kemi konstatuar se ekzekutimi i buxhetit ishte i një niveli jo të kënaqshëm, sidomos për investimet kapitale. Kjo ka rrjedhur kryesisht nga mos realizimi i projekteve për investime kapitale, si pasojë e mangësive që nga fazat e hartimit të projekteve deri në finalizimin e tyre, si rezultat i mosfunksionimit të kontrollit të brendshëm.

Rekomandimi 2

Ne rekomandojmë Ministren e MTI-së të siguroj:

- Forcimin e kontrollit në mënyrë që buxheti të shpenzohet në pajtueshmëri të plotë me kornizën ligjore dhe identifikimin dhe eliminimin e dobësive të cilat kanë ndikuar që shpenzimi i buxhetit të mos jetë në përputhshmëri të plotë me planin e rrjedhës së parasë.

5 Pasqyrat vjetore financiare – Pajtueshmëri me kornizën raportuese dhe cilësinë e informacionit

Bazuar në kërkesat e LMFP nr. 03/L-221 dhe Rregullës financiare nr. 07/2011, ne kemi identifikuar pikat në vijim:

- Pasqyrat financiare janë në harmoni me kërkesat e Rregullës financiare nr. 07/2011 mbi Raportimin Vjetor të Organizatave buxhetore dhe SNKSP “Raportimin Financiar në bazë të parasë së Gatshme”
- Pasqyrat Financiare janë nënshkruar nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe Zyrtari Kryesor Financiar me datën 31.01.2012.
- Pasqyrat Financiare janë dorëzuar në MEF/Thesar, me datën 31.01.2012. Mirëpo pas sugjerimit tonë për korrigjim, versioni i fundit është dorëzuar me datën 02.03.2012
- Gjatë vitit 2011, MTI-ja ka dorëzuar raporte të rregullta financiare tremujore tek Ministri i MEF-it.

Përgatitja e pasqyrave financiare duhet të përmbajë procedura dhe mjete të përcaktuara për të siguruar që informacioni i kërkuar është regjistruar, proceduar, përmbledhur dhe raportuar drejt në pasqyra financiare.

Përkundër korrigjimeve të bëra, ende kishte mangësi në prezantimin e pasqyrave financiare. Nuk ishte bërë korrigjimi në shumë 5,556€ për donacionin nga banka botërore dhe në shënimin 36 për ndarjet fillestare dhe finale të buxhetit gjatë vitit 2011 nuk ishin prezantuar.

Konkluzioni

Me përjashtim të qështjeve sa i përket shpalosjeve rreth korrigjimeve dhe ndryshimeve buxhetore të ndodhura gjatë vitit 2011, informatat tjera janë në pajtim me kornizën ligjore të raportimit financiar dhe RrF nr. 07/2011. Qështjet e theksuara me lartë nuk janë materiale dhe si rezultat nuk reflektojnë ndikimin e tyre në dhënien e opinionit për sa i përket PVF-ve.

Rekomandimi 3

Ne rekomandojmë Ministren e MTI-së që të siguroj:

- Që informatat e shpalosura në PVF në lidhje me identifikimin e fondeve për shpenzime të jenë vërteta dhe të drejta; dhe
- Se përmirësimet e tyre do të bëhen gjatë përgatitjes së pasqyrave financiare nëntë mujore të këtij viti.

6 Menaxhimi financiar

6.1 Të hyrat (duke përfshirë ato vetjake)

Për vitin 2011 të hyrat e mbledhura nga MTI ishin në shumë prej 3,385,307€. Të hyrat më të larta të mbledhur gjatë vitit 2011 ishin nga taksa rrugore, pronësia industriale, shitja e aseteve (automjeteve përmes ankandit publik), regjistrimi i bizneseve, licencat për importin e naftës dhe derivateve.

Ndërprerja e dhënies së licencave subjekteve ndërtimore

Sipas Ligjit për Ndërtim, Ministria me akte administrative do të përcaktoje kushtet dhe masat e licencimit. Me datën 16.09.2011, Ministria e MTI-se kishte marrë vendim për shfuqizimin e UA për dhënien e licencave subjekteve ndërtimore, pa siguruar ndonjë ndryshim të ligjit përkatës apo alternativë tjetër me akte nënligjore për licencim.

Ne nuk kemi mundur të sigurohemi që vendimi i marrë për ndërprerjen e dhënies së licencave subjekteve ndërtimore është në pajtueshmëri me Ligjin për Ndërtim.

Mangësitë e identifikuar për të hyrat e mbledhura gjatë vitit 2011 i kemi paraqitur në vijim:

Dhënia e licencave subjekteve afariste nuk ishte në pajtueshmëri të plotë me kornizën ligjore

Ne kemi konstatuar se procesi i dhënies së licencave gjatë vitit 2011 nuk ishte zhvilluar në pajtueshmëri të plotë me kriteret e përcaktuara ligjore,

Mangësitë e identifikuar për mostrat e testuara për dhënien e licencave i kemi paraqitur në vijim:

- Sipas UA 07/2010 licencat duhet të përmbajnë numrin rendor dhe datën e lëshimit. Në pesë raste kemi identifikuar se licencat e lëshuara subjekteve afariste për importin e naftës, shitje me shumicë dhe pakicë të naftës dhe derivateve të saj ishin nënshkruar nga ministria e MTI-së për periudhën paraprake kur nuk ka qene në këtë pozitë (MTI një periudhe e kishte të zbrazët pozitën e ministrit).
- Sipas Ligjit Nr.03/L-138 për tregti me naftë dhe derivate të sajë, licencat i nënshkruan ministri. Në zyrën e licencimit deri me datën 18.10.2011 ishin 237 vendime. Prej tyre 7 vendime nga ishin nga viti 2010, që ishin në pritje për nënshkrim nga Ministria. Ndërsa ata kishin vazhduar me nënshkrimin e licencave për vendimet marra në vitin 2011, siç ishte rasti me licencën nr.588-V1 sipas vendimit të datës 05.05.2011, kurse ato të vitit 2010 akoma ishin në pritje. Vonesat

e tilla ndikojnë në favorizimin e disa subjekteve afariste duke dëmtuar subjektet tjera që presin kohe të gjatë për marrjen e licencave.

- Sipas UA nr 07/2010, kërkesa për rilicencim duhet të bëhet 60 ditë para afatit të skadimit të licencës. Në rastet kur subjekti afarist nuk parashtroi kërkesën për vazhdimin e licencës në afatin prej 60 ditësh, duhet të aplikoj për licencim, dhe të paguaj taksen që është 50% me lartë se sa taksa që duhet të paguhet për vazhdimin e licencës. Po ashtu afati vlefshmërisë së licencës do të jetë dy vite nga data e lëshimit të licencës
- Ne kemi identifikuar vonesa në parashtimin e kërkesave për vazhdimin e licencave në dy raste.
- Për vazhdimin e licencës nr. 722-V2 të datës 10.02.2011 kemi identifikuar se parashtimi i kërkesës ishte bërë me vonesë prej 130 ditësh, po ashtu afati i vlefshmërisë së licencës nuk ishte dy vite nga data e lëshimit; dhe
- Licenca nr. 338-V2 ishte nënshkruar me datën 22.11.2011, ndërsa data e paraqitur në licence ishte 23.12.2010. Andaj ne kemi konstatuar se nuk ishte zbatuar afati për vlefshmërinë e licencës dy vite nga data e lëshimit.
- Sipas Ligjit 03-L-138 në afat prej 30 ditësh nga data e parashtimit të kërkesës nga subjektet afariste, zyra e licencimit duhet të merr vendim për aprovimin e kërkesës për licencim. Në dy raste kemi konstatuar se komisioni nuk kishte marrë vendim brenda afatit të përcaktuar ligjor, që rezultonin me vonesa mbi 45 ditë pas afatit ligjor;
- Sipas UA 16/2010 shuma e paguar e taksës për parashtimin e kërkesës për licencim i'u rimbursohet parashtguesve të kërkesave me rastin e aprovimit të kërkesave për licencim. Ne kemi identifikuar katër raste, që nuk i'u ishte bërë rimbursimi i taksës së paguar parashtguesve të kërkesave;
- Sipas UA Nr. 07/2010, subjekti afarist i cili aplikon për licencë duhet të sjellë dëshminë se ka përmbushur tërësisht obligimet ndaj institucioneve shtetërore siç janë taksat, tatimet dhe detyrimet tjera. Licenca me nr. 1540 i është dhënë subjektit afarist pa sjellur dëshminë për përmbushjen e obligimeve ndaj institucioneve shtetërore;
- Sipas UA nr. 07/2010, tërheqja e licencave duhet të bëhet nga subjekti i licencuar në afat prej 15 ditësh nga dita e njoftimit për lëshimin e saj. Nëse licenca nuk tërhiqet në afatin e përcaktuar atëherë subjekti afarist duhet të ndëshkohet konform ligjit në fuqi. Ne kemi identifikuar se nuk ishin aplikuar ndëshkime ndaj subjektit afarist për licencën (nr. 1673) që ishte tërhequr me vonesë prej 53 ditë pune;
- Sipas UA nr.07/2010 për pocdurat e licencimit licenca do të lëshohet pasi parashtguesi i kërkesës të paraqet dokumentin për shumën e paguar të tarifës për

licence. Për vazhdimin e licencës nr. 722-V2 të datës 10.02.2011 pagesa ishte bërë pas lëshimit të licences me datën 21.04.2011.

- Sipas UA 10/2010 të MTI-së i cili ishte në fuqi deri me datën 16.09.2011, në departamentin e ndërtimtarisë, kërkesa për vazhdimin e licencës duhet të bëhet jo me vonë se 30 ditë nga skadimi i afatit të vlefshmërisë. Ndërsa kërkesa për vazhdim e licencës nr. 917/ ishte bërë me vonesë prej 35 ditësh pas afatit të përcaktuar ligjor.

Konkluzioni

Ne kemi konstatuar se mangësitë e identifikuar gjatë dhënies së licencave siç ishin: vonesat lidhur me nënshkrimin e licencave, pajisja e subjekteve afariste me licenca dhe dhënia e licencave disa subjekteve afariste pa i plotësuar kriteret ligjore janë si rezultat i mosfunksionimit të mirëfilltë të kontrollit të brendshëm dhe krijon hapësirë për favorizimin e disa subjekteve afariste.

Rekomandimi 4

Ne rekomandojmë Ministren e MTI-së të siguroj:

- Që lëshimi i licencave të bëhet në pajtueshmëri të plotë me legjislacionin në fuqi dhe marrjen e masave të nevojshme për forcimin e kontrollit në mënyrë që të evitohen e mangësitë e identifikuar.

6.2 Shpenzimet

6.2.1 Kompenzimet (pagat dhe mëditjet,)

Buxheti final për paga dhe mëditje për vitin 2011 ishte në shumë 1,022,122€ nga kjo shumë ishin shpenzuar 953,599€ ose në masën 93%.

Mangësitë e vërejtura rreth kësaj kategorie i kemi paraqitur tek kapitulli i sistemit të kontrollit të brendshëm.

6.2.2 Prokurimi

Sipas planit të prokurimit për vitin 2011, vlera e parashikuar e kontratave ishte në shumë 5,986,222€ (në këtë shumë nuk është përfshirë shuma e planifikuar e kontratave për pune me koncesion), ndërsa vlera e kontratave të nënshkruara ishte në shumë 799,163€ ose në masën 13% .

Mos realizimi i planit të prokurimit sipas shpjegimeve të MTI-së ishte për disa arsye. Shuma prej 236,587€ e planifikuar për pajisje për laborator të industrisë kimike ishin barte ne projektin kapital të laboratorit të industrisë kimike. Mjetet në shumë prej 325,000€ për blerjen e veturave nuk ishin ndarë për shkak të miratimit të buxhetit me vonesë. Mjetet e parapara në shumë prej 200,000€ për furnizimin e institutit të ndërtimit me pajisje laboratorike dhe inventar ishin bartë për projektin kapital për laboratorin e ndërtimtarisë. Shuma prej 1,550,000€ që kanë qenë donacione nga banka botërore nuk ishin realizuar. Për pjesën tjetër që nuk ishin realizuar. As projektet tjera në shumë prej 2,875,472€ nuk ishin realizuar.

Në auditimin tonë ne kemi përzgjedhur 47 mostra nga pagesat e ndodhura në SIMFK në vlerë 3,175,191 dhe tetë (8) mostra nga raporti vjetor i kontratave të prokurimit në vlerë e 556,097€ nga vlera e përgjithshme e kontratave të nënshkruara.

Ne kemi paraqitur të gjeturat e identifikuar gjatë auditimit nga mostrat e testuara për shpenzimet e realizuara gjatë vitit 2011.

Rastet e paraqitura janë projekte që janë trajtuar edhe në raportin tonë për vitin 2010 e që nuk janë përfunduar gjatë vitit 2011

Gjatë auditimit ne kemi përcjellur se a janë kryer punimet për projekte që janë trajtuar në raportin e vitit 2010. Ne kemi konstatuar se për dy projektet në vijim nuk ishin kryer punimet as gjatë vitit 2011:

Për “Ndërtimin e Rrjetit për Furnizim Emergjent me Energji në Parkun e Biznesit në Drenas”, pagesat në shumë 1,448,000€ ishin bërë në vitin 2009, por punimet ende nuk kishin përfunduar në vitin 2011.

Afati për përfundimin e punimeve në kontratën e nënshkruar më datën 13.07.2010 në shumë 284,814€ për “Ndërtimin e kanalizimit të impiantit për pastrimin e ujërave të zeza dhe industriale të Parkut të Biznesit dhe Zonës Industriale” në Drenas, ishte 21 ditë pune, ndërsa punimet edhe gjatë vitit 2011 nuk ishin përfunduar. Vonesat në realizimin e projektit janë shkaktuar nga mos zgjidhja e problemeve pronësore.

Zhvillimi i punimeve pa leje të ndërtimit

Sipas ligjit për ndërtim Nr.2004/15 punët ndërtimore nuk mund të fillojnë para se të merret leja e ndërtimit. Gjithashtu leja e ndërtimit dhe dokumentet shoqëruese duhet të mbahen në dispozicion në vendin e ndërtimit që nga fillimi i veprimeve të ndërtimit.

Ne tri raste kemi identifikuar se punimet kishin filluar pa leje të ndërtimit si në vijim:

- Për projektin “Ndërtimi i Objektivit të Laboratorit të Industrisë Kimike” kontrata ishte nënshkruar me datën 29.07.2009 në shumë 1,937,957€. Ne kemi identifikuar se aktvendimi për lejin e ndërtimit nga drejtorja e urbanizmit, ndërtimit dhe

mbrojtjes se mjedisit nga komuna e Prishtinës ishte lëshuar me datën 02.02.2012 ose 18 muaj pas fillimit të punimeve;

- Kontrata për “Ndërtimin e Qendrës së Panairëve” në Bernicë të Poshtme në shumë 3,831,589€, ishte nënshkruar me datën 09.11.2009..Aktvendimi për lejimin e ndërtimit nga komuna e Prishtinës ishte lëshuar me datën 19.01.2012 ose 13 muaj pas fillimit të punimeve;
- Për projektin “Finalizimi i Fazës IV në Parkun e Biznesit”, MTI nuk ishte në gjendje të ofroje dëshmi se kishte leje ndërtimi për këtë projekt nga komuna. Në kontratën e nënshkruar me datën 29.09.2009 në shumë 612,858€, afati i përcaktuar për finalizimin e punimeve ishte 53 dite pune. Në kemi identifikuar se punimet akoma nuk ishin kryer në tërësi, vlera e punëve të kryera, të raportuara deri me tani, ishte në shumë 525,274€. Deri më datën 23.02.2012 MTI nuk ishte në gjendje të na ofrojë dëshmi për kryerjen e punimeve në tërësi.

Pranimi teknik nuk ishte në pajtueshmëri të plotë me kushtet e kontratave

Objektet duhet të pranohen nga komisioni teknik për punët e përfunduara në tërësi. Në dy raste ne kemi vërejtur se ishte bërë pranimi teknik i objekteve pa u kryer punimet sipas kushteve të kontratave .

Kontrata për Ndërtimin e Laboratorit të Industrisë Kimike ishte në shumë (përfshirë edhe aneks kontratën) prej 2,047,212€. Nga kjo shume ishin paguar 2,033,473€, mangësitë e identifikuar i kemi paraqitur në vijim:

Në raportin e Komisionit për pranimin teknik të datës 14.12.2011 nuk janë përshkruar të gjitha mangësitë për punët e pakryera. Në raport ishin prezantuar si punë të pakryera vetëm kycja në rrjetin e ujësjellësit dhe kycja në rrjetin elektrik që ishin në shumë 13,739€.

Çështjet tjera që nuk ishin përshkruar në raportin e komisionit për pranim teknik siç janë: kulmi dhe pllafonet e tavaneve kishin lëshuar ujin dhe ishin dëmtuar si pasoje e dobësive të ndërtimit. Punimet e sipërfaqeve të rrugëve, shesheve dhe stazave që nuk ishin vendosur ashtu siç janë kërkuar në paramasë dhe parallogari të tenderit.

Në kontratën nënshkruar me datën 09.11.2009 (përfshirë edhe aneks kontratën) “Ndërtimi i Qendrës së Panairëve” në Bernicë të poshtme në shume totale 4,047,365€, nga të cilat 4,015,978€ ishin paguar deri me datën 22.12.2011. Krahës vonesave të theksuara në zbatimin e kësaj kontrate janë identifikuar edhe mangësi si në vijim: Komisioni për pranim teknik dhe organi mbikëqyrës nuk kishin prezantuar në raport të gjitha punët e pakryera. Si punë të papërfunduara kishin paraqitur vetëm punët e gjelbërimit dhe dekorimit të kopshtit në shumë 16,448€.

Disa prej pozicioneve që ishin prezantuar si punë të kryera nuk kishin qenë të kryera. Deri me datën 02.03 2012 punë të pakryera në tërësi ishin si në vijim: punimet e

dyshemesë së objektit, mbulesës, trotuareve, knaufit, rrjetit të ujësellsit, trpat ngrohës dhe tubacionet, hapja e pusit furnizimi dhe instalimi i pajisjeve për shuarje automatike të zjarrit. për të cilat punimet ishin ende në proces.

Pagesa nuk ishte bërë nga kodi adekuat i projektit

Sipas nenit 15 të ligjit të buxhetit 04/L-001 për vitin 2011 ndryshimet në mjetet e alokuara për projekte kapitale mund të bëhen nga Ministri i Financave nëse ofrohen arsyetime të vlefshme nga kryesuesi i organizatës buxhetore.

Për Kontratën e nënshkruar me datën 03.09.2010 (përfshirë edhe aneks kontratën e nënshkruar me datën 22.02.2011) për projektin 10941 “Kuçja e Parkut te Biznesit-Drenas ne Magjistralen Prishtinë –Pejë” në shumë totale 315,780€, vlera totale e pagesave ishte 311,871€.

Ne kemi konstatuar se Pagesa në shumë prej 20,147€ ishte paguar nga një kod tjetër i projektit (10940) e jo me kodin e projektit për të cilin është nënshkruar kontrata. Mënyra e tillë e pagesës është në kundërshtim me nenin 15 të ligjit për buxhet.

Personat e njëjtë janë caktuar ne komision për vlerësimin e ofertave dhe pranimin teknik

Anëtarët e komisionit për vlerësimin e ofertave duhet të jene të ndryshëm me anëtarët që caktohen për pranimin teknik. Në dy raste kemi identifikuar që personat e njëjtë ishin caktuar në dy komisione për projekte të njëjta si në vijim:

- Në lidhje me kontratën e nënshkruar me datën 14.12.2011 “Furnizimi me pajisje për laboratorë” në shumë 56,473€ e që ishte paguar në tërësi, ne kemi identifikuar se personi i njëjtë kishte qenë anëtarë në komisionin e vlerësimit të ofertave dhe në komisionin për pranimin teknik të furnizimit me pasjeve për laboratorë; dhe
- Menaxheri i projektit për ndërtimin e Qendrës së Panairëve në Bernice ishte edhe kryetar i komisionit për vlerësimin e ofertave për këtë projekt, që nuk është ndarje e drejtë e detyrave.

Çmimi i paraqitur në kontratë është i ndryshëm me çmimin e ofertës

Në kontratë duhet të paraqitet çmimi i ofruar në ofertën e kompanisë fituese. Ne kemi identifikuar se çmimi i ofruar nga operatori ekonomik fitues për servisim dhe mirëmbajtje për veturën Audi Q7 ishte në shumë 8,662€, ndërsa në kontratë është specifikuar se çmimi i shërbimeve nuk guxon të tejkalojë shumën prej 10,000€. Nga kjo shihet se vlera e kontratës nuk ishte në përputhshmëri me çmimin e operatorit fitues.

Konkluzioni

Ne kemi konstatuar se kishte mangësi gjatë procesit të mbikëqyrjes për realizimin e punimeve për investime kapitale. Mungesa e vendosjes së një sistemi të duhur për kontrollin e brendshëm ka rezultuar që pagesat dhe pranimi teknik të bëhet për punët e papërfunduara në tërësi sipas sasisë, cilësisë, kushteve dhe afateve të përcaktuara me kontrata.

Realizimi i pagesave për punët e pakryera lëne hapësirë për keqmenaxhim të buxhetit dhe rrisin rrezikun që punimet të mbesin të papërfunduara në tërësi edhe pse janë bërë pagesat.

Rekomandimi 5

Ne rekomandojmë Ministren e MTI-së që të siguroj:

- Mbikëqyrjen e duhur të projekteve afatgjata dhe dizajnimin e një sistemi që do të identifikonte dhe eliminonte mangësitë evidente në mënyrë që projektet të realizohen në pajtueshmëri me standardet e kërkuara në aspektin cilësor dhe sasior; dhe
- Që pagesat për projekte kapitale të bëhen në pajtueshmëri me realizimin e projekteve.

6.3 Pasuritë

Vlera origjinale e pasurive sipas regjistrit kontabël të pasurive ishte në shumë 19,851,387€ ndërsa pas zhvlerësimit vlera neto ishte 17,256,634€.

Gjatë auditimit ne kemi analizuar se a janë regjistruar a jo pasuritë drejtë dhe saktë në regjistrin kontabël sipas sasisë dhe vlerës dhe a janë prezantuar drejtë në pasqyra financiare gjatë vitit 2011.

Regjistrat e pasurive nuk ishin në pajtueshmëri të plotë me UA 21/2009

Sipas nenit 3 të UA 21/2009 pasuri kapitale janë të gjitha ato pasuri që kanë edhe vlerë me tepër se 1000€. Pasuritë në regjistrin e pasurive dhe në regjistrat kontabël duhet të regjistrohen në bazë të faturës dhe fletëpranimit të pasurive.

Ne kemi vërejtur se kishte përmirësime sa i përket regjistrimit të pasurive në krahasim me vitin 2010. Edhe përkundër përmirësimeve akoma janë identifikuar mangësi në regjistrat e pasurive. Në regjistrat kontabël të pasurive janë regjistruar edhe pasuritë që kanë vlerë nën 1,000€, e që janë kategorizuara si kapital tjetër.

Instalimi i Softwerit për kontabilitetin e dyfishtë ne shumë 8,625€ nuk ishte funksionalizuar

Sipas kontratës me numër të prokurimit MTI204/08/108/236, për programin e kontabilitetit, instalimi i softwerit të financave- kontabilitetit te dyfishtë, parashihte edhe trajnime suplementare për menaxher. Ne kemi konstatuar se programi për kontabilitetin e dyfishtë i pranuar në vitin 2008 nuk ishte funksionalizuar akoma, për shkak të mungesës së stafit të trajnuar për përdorimin e këtij softueri.

Menaxhimi i automjeteve

Përdorimi i automjeteve duhet të bëhet në pajtueshmëri me procedurat e përcaktuara në UA 03/2008 për përdorimin e rregullt dhe efikas të automjeteve siç janë: Plotësimi i kërkesës për shërbime të vozitjes, ku çdo drejtues është i obliguar që në fletudhëtim të shënoj numrin e kilometrave në momentin e nisjes dhe të kthimit, mbajtja e evidencës së plotë për shpenzimet e karburanteve dhe të mirëmbajtjes. Auditimi ynë shpalosi të gjeturat në vijim:

Në kemi identifikuar se nga dhjetë mostra të testuara, në katër raste kërkesat për shfrytëzimin e automjeteve dhe fletudhëtimet nuk ishin plotësuar në pajtueshmëri kriteret e përcaktuara në UA 03/2008 dhe nuk kishte evidencë të plotë për shpenzimin e derivateve dhe mirëmbajtjen e automjeteve.

Konkluzioni

Ne kemi konstatuar se menaxhimi i pasurive me të cilat disponon ministria nuk bëhet në mënyre efektive dhe efikase si pasojë e mungesës së stafit profesional për përdorimin e tyre. Po ashtu edhe në menaxhimin e automjeteve janë konstatuar dobësi si pasojë e mungesës së kontrollit të mjaftueshëm.

Rekomandimi 6

Ne rekomandojmë Ministren e MTI-së që të siguroj:

- Që pajisjet e blera, ministria ti vë në funksion dhe ti përdorë në mënyrë efikase; dhe
- Shfrytëzimin e automjeteve në pajtueshmëri të plotë me UA 03/2008.

6.4 Raportimi aktual dhe afatet kohore për procesin e përgjithshëm buxhetor

Ne kemi vlerësuar se MTI i ka përmbushur kërkesat aktuale për raportimin e jashtëm, si:

- Raportet për obligimet e papaguara ishin dorëzuar në MEF;
- Plani i veprimit për implementimin e rekomandimeve;
- Planin final të prokurimit të dorëzuar me kohë; dhe
- Raportet tremujore, duke përfshirë pasqyrat financiare nëntë mujore me kohë;

7 Kontrolli menaxherial

7.1 Sistemet e kontrollit të brendshëm

Ne kemi identifikuar mangësi në funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm në fushat e paraqitura në seksionet më lartë. Mangësitë e vërejtura në sistemin e kontrollit të brendshëm rezultojnë me menaxhim jo efektiv në shpenzimin e parasë publike.

Në dosjet e personelit kemi vërejtur mangësitë rreth menaxhimit të stafit si në vijim:

MTI nuk kishte zbatuar kriteret e ligjit për shërbimin civil për pozitat si ushtrues detyre, sipas të cilit ushtruesi i detyrës nuk mund të emërohet në afat më gjatë se tre (3) muaj.

- Në pozitën si Drejtori departamentit të rezervave shtetërore (me vendim të Sekretares permanente) është caktuar një ushtrues detyre në këtë pozitë me datën 08.06.2011 dhe vazhdon të mbajë këtë pozite deri në fund të vitit 2011, si ushtrues detyre.
- Në pozitën e kryeshefit të Agjencisë për regjistrimin e bizneseve, ushtruesi i detyrës është emëruar me datën 22.01.2008 dhe ende ishte në këtë pozitë edhe gjatë vitit 2011.

Konkluzioni

Ne kemi konstatuar se nuk ishte zbatuar ligji për shërbimin civil 03/L-147 për sa i përket kohëzgjatjes së afatit për stafin që ishte caktuar ushtrues detyre në pozitat menaxhuese.

Rekomandimi 7

Ne rekomandojmë Ministren e MTI-së që të siguroj:

- Zbatimin e kriterëve të përcaktuara në pajtueshmëri të plotë ligjin e shërbimit civil për stafin e punësuar në kuadër të MTI-së;
- Identifikimin e shkaqeve për mosfunksionimin e kontrollit të brendshëm; dhe
- Funksionimin e mirëfilltë të kontrollit të brendshëm duke bërë ndarje të drejt të detyrave dhe marrjen e masave të nevojshme për eliminimin e dobësive të identikuara.

7.2 Auditimi i brendshëm

MTI ka formuar Komitetin e auditimit i cili përbehet prej 3 anëtareve. NJAB ka përgatitur planin strategjik për periudhën 2010 - 2012 dhe planin vjetor për vitin 2011.

Në Planin Vjetor të Auditimit për vitin 2011 MTI ka planifikuar gjashtë (6) auditime: auditimin e procedurave të licencimit në Departamentin e Turizmit, Ndërtimtarisë, rekrutimin në Administratën Qendrore, menaxhimin e shpenzimeve, menaxhimin e të hyrave dhe auditimin në zyrën e prokurimit. Ndërsa dy auditime shtesë ishin kryer sipas kërkesës së menaxhmentit.

Gjatë vitit 2011 ishin finalizuar tetë raporte të auditimit që ka mbuluar çështjet në vijim: menaxhimin e shpenzimeve; menaxhimin e personelit; procedurat e verifikimit të licencimit të subjekteve ndërtimore; procedurat e licencimit të objekteve hoteliere dhe agjencive turistike dhe menaxhimi i të hyrave, menaxhimi i prokurimit, ekzaminim i dosjes për tenderin me nr. prokurimit MTI204/11/058/511 dhe Procedurat e dhënie së licencave subjekteve afariste.

Këto auditime i kanë trajtuar çështjet përkatëse dhe kanë dhënë rekomandimet adekuate.

Komiteti i auditimit gjatë vitit 2011 nuk ishte funksional (nuk kishte mbajtur takimet e rregullta) për shkak se nuk ishte në përbërje të plotë gjatë tërë vitit 2011.

Konkluzioni

Ne kemi konstatuar se komiteti i auditimit si një organ këshillëdhënës për menaxhmentin nuk ishte efikas gjatë vitit 2011. Mosfunksionimi i vazhdueshëm i komitetit të auditimit ndikon në mungesën e kontrollit për sigurinë e mbikëqyrjes së planeve të auditimit dhe implementimin e rekomandimeve të auditimit.

Rekomandimi 8

Ne rekomandojmë Ministren e MTI-së të siguroj:

- Funksionimin e komitetit të auditimit në nivelin e duhur dhe të vazhdueshëm; dhe
- Që NJAB gjatë auditimit të përfshijë fushat që paraqesin rrezik me të lartë përfshirë edhe mbikëqyrjen e projekteve kapitale në mënyrë që ti ndihmojnë dhe ti shtojnë vlerë menaxhimit të organizatës.

8 Një konkluzion i përgjithshëm mbi menaxhmentin e MTI-së

MTI nuk kishte arritur të krijoj një mjedis funksional të kontrollit të brendshëm i cili do të siguroj një menaxhim efektiv të parasë publike.

Mangësi kishte gjatë procesit të licencimit dhe zbatimit të kornizës ligjore lidhur me lëshuarjen e licencave.

Mbikëqyrja e realizimit të projekteve dhe pranimit teknik të tyre nuk ishte zhvilluar në pajtim të plotë me kornizën e aplikueshme ligjore. Gjatë rekrutimit të stafit nuk ishin respektuar kriteret e përcaktuara.

Për funksionalizimin e pasurive menaxhmenti nuk kishte marre masat e nevojshme për t'i vënë në përdorim, mos vënia në përdorim e pasurive ndikon në dëmtimin e buxhetit duke krijuar hapësirë për humbje dhe keqpërdorimin e tyre.

MTI nuk i ka adresuar të gjitha mangësitë. Masat e marra në lidhje me rekomandimet e auditimit nuk ishin të mjaftueshme.

Duke u bazuar në mangësitë e prezantuara vijmë në konkluzionin të përgjithshëm se nevojiten masa shtesë nga menaxhmenti i MTI-së për përmirësimin e funksionimit të mirëfilltë për sistemin e kontrollit të brendshëm.

Rekomandimi 9

Ne rekomandojmë Ministren e MTI-së që të siguroj:

- Dizajnimin e një sistemit të mirëfilltë që do të ndikojë në forcimin e kontrolleve të përgjithshme, për të ofruar siguri që aktivitetet operative dhe menaxhimi financiar funksionojnë në pajtim me objektivat e vendosura të MTI-së.

Shtojca I. Llojet e ndryshme të Opinioneve të Auditimit

(e shkëputur nga SNISA 400)

9. Një opinion i auditimit normalisht është një format standard, ndërlidhur me pasqyrat financiare si tërësi, duke shmangur nevojën për të caktuar gjatësinë e saj por duke bartur sipas natyrës së saj një kuptim të përgjithshëm tek lexuesit sipas kuptimit të saj. Natyra e këtyre fjalëve do të ndikohet nga korniza ligjore të auditimit, por përbërja e opinionit duhet të tregoj qartë a është i pakualifikuar apo i kualifikuar, apo nëse është i kualifikuar në disa çështje të caktuara apo është opinion i kundërt (paragrafi 14), apo është mohim i opinionit (paragrafi 15).

10. **Një opinion i pakualifikuar** jepet kur auditori është i kënaqur në të gjitha aspektet materiale që:

a) pasqyrat financiare janë përgatitur duke shfrytëzuar baza dhe politika të pranuar të kontabilitetit të cilat janë zbatuar në mënyrë konsistente (të qëndrueshme);

b) pasqyrat janë në pajtim me kërkesat statusore dhe rregulloret relevante;

c) pamja e paraqitur në pasqyrat financiare janë në përputhje me njohuritë e auditorit në lidhje me entitetin e audituar;

d) është një shpalosje adekuate e të gjitha çështjeve materiale relevante për pasqyrat financiare.

11. **Theksi i çështjeve.** Në disa rrethana auditori mundet të konsideroj se lexuesi nuk do të kuptoj në mënyrë të duhur pasqyrat financiare nëse vëmendja është përqendruar në çështje të pazakonshme apo të rëndësishme. Si një rregull e përgjithshme, auditori kur jep një opinion të pakualifikuar kjo nuk i referohet ndonjë aspekti specifik të pasqyrave financiare në opinionin e tij në rast se kjo mund të interpretohet gabimisht si opinion i kualifikuar. Me qëllim të shmangies së kësaj përshtypjeje, referencat që janë menduar si; nënvizim i çështjes; gjinden në paragrafët e ndara nga opinionin. Sidoqoftë, auditori nuk duhet të përdor nënvizimin e çështjes për të përmirësuar mungesën e shpalosjeve të duhura në pasqyrat financiare apo si alternativ, zëvendësim për kualifikim të opinionit.

12. Auditori mund të mos jetë në gjendje të shpreh një opinion jo të kualifikuar kur ekziston një nga ato rrethana dhe në gjykimin e auditorëve, afektin e tyre është ose mund të jetë materiale për pasqyrat financiare:

- a) Ka pasur limitime në fushëveprimin e auditimit;
- b) Auditori konsideron që pasqyrat janë jo complete apo çorientues apo ekziston një ndarje e pajustificuar nga standardet e pranueshme të kontabilitetit; apo
- c) Ekzistojnë paqartësi që ndikojnë në pasqyrat financiare.

13. **Opinion i Kualifikuar.** Aty ku auditori nuk pajtohet apo nuk është i sigurt në lidhje me një ose me tepër artikuj të veçantë në pasqyrat financiare e që janë materiale por jo edhe fundamentale në kuptimin e pasqyrave, duhet të jepet një opinion i kualifikuar. Formulimi i opinionit normalisht tregon një rezultat të kënaqshëm ndaj subjektit të audituar, sa i përket një pasqyre të qartë dhe koncize, të çështjeve të mospajtimit apo edhe të paqartësive që ngrisin opinion e kualifikuar. I ndihmon përdoruesit e pasqyrave nëse efekti financiar i paqartësisë apo edhe i mosmarrëveshjeve është përcaktuar nga ana e Auditorit edhe pse kjo nuk është gjithmonë praktike apo relevante.

14. **Opinion i Kundërt.** Aty ku Auditori nuk ka mundësi të jap një opinion mbi pasqyrat financiare në tërësi, për shkak të mosmarrëveshjeve që është aq thelbësore ngase e minon pozitën e prezantuar në vazhdim që opinionin që kualifikohet në aspekte të caktuara nuk do të jetë adekuat, atëherë jepet opinion i Kundërt. Formulimi i një opinionin të tillë e bën të qartë se pasqyrat financiare nuk janë prezantuar në mënyrë të drejtë, duke specifikuar qartë dhe në mënyrë koncize të gjitha çështjet e mosmarrëveshjeve. Përsëri, është një ndihmesë që efekti financiar mbi pasqyrat financiare përcaktohet aty ku duhet dhe është praktik.

15. **Mohimi i Opinionit.** Aty ku Auditori nuk mund të jep opinion në lidhje me pasqyrat financiare, të marrë si tërësi për shkak të paqartësisë apo restriktionit të fushëveprimit që është thelbësor që një opinion që është i kualifikuar në aspekte të caktuara nuk do të jetë adekuat, jepet opinion i kundërt. Formulimi i një opinionin të tillë e bënë të qartë që një opinion nuk mund të jepet, duke specifikuar në mënyrë të qartë dhe koncize të gjitha çështjet e paqarta.

16. Është bërë zakon që ISA të ofrojnë një raport të detajuar për të plotësuar opinion në rrethana në të cilat është e pamundur të jepet një opinion jo i kualifikuar.

Shtojca II: Rekomandimet e vitit të mëhershëm

Komponenta e Auditimit	Rekomandimet e dhëna	Rekomandimet plotësisht të implementuara	Pjesërisht të adresuar	Të pa adresuara
III. Gjendja e rekomandimeve të viteve të kaluara.	Adresimin e rekomandimeve tona të cilat do të mundësojnë krijimin e parakushteve të nevojshme për menaxhimin efektiv të ministrisë		X	
IV. Buxheti i shpenzuar në krahësim me buxhetin e aprovuar	Planifikim dhe përdorim efikas dhe racional të buxhetit duke u bazuar në identifikimin e drejtë të nevojave buxhetore.			
V. Pasqyrat financiare	Korrigjimin e gabimeve në regjistrat kontabël dhe regjistrimin e plotë të pasurive të jenë në pajtim me kërkesat e raportimit financiar, si dhe paraqitjen e tyre të saktë në PVF. Prezantimin dhe shpalosjen e të hyrave në PVF sipas programeve adekuatë të përcaktura në planin kontabël.			X

VI.1 Të hyrat	Regjistrimin e të hyrave në programet sipas kodeve adekuate, në mënyrë që të prezantohet drejtë dhe saktë të hyrat e inkasuara. Që licencat e dhëna subjekteve për ushtrimin e punëve në sektorin e ndërtimit të janë në pajtim të plotë me kushtet dhe kriteret e përcaktuara me UA 10/2010 . Që shitja e mallrave përmes ankandeve publike, të jetë në pajtim të plotë me UA 2008/3 për procedurat e shitjes së mallrave me ankand publik.		X	
VI.2 (2.2)Kompensimet (Pagat dhe mëditjet)	Përzgjedhjen e kandidatëve në pajtim me ligjin nr.03/L për shërbimin Civil dhe zbatimin e vendimeve të nxjerra nga KPM.	x		
VI.3 Subvencionet dhe transferet	Vendosjen e kontrolleve të mjaftueshme për shpenzimin e parave nga subvencionet në mënyrë që kontratat e përgjithshme për projektet fituese tu paraprijnë kontratave të veçanta. Që të mos bëhen shpenzime të para nënshkrimit për projekte të caktuara dhe zotimi i mjeteve të bëhet para nënshkrimit të kontratave.	MTI Nuk kishte buxhet për subvencione dhe transfere për vitin 2011		

3.1 Pasuritë kapitale dhe jo kapitale	Mbajtjen e të dhënave të sakta për pasurinë sipas sasive dhe vlerës. Shfrytëzimin e veturave në pajtim të plotë me UA 03/2008 dhe evidenca të sakta rreth shërbimeve të mirëmbajtjes se tyre. Që shpenzimet e karburanteve për automjete të jenë brenda normës së paraparë. Në raste kur vërehen shpenzime mbi normën e lejuar të analizohen dhe të gjinden shkaqet dhe të merren masat e nevojshme për evitimin e tyre.			X
VII.1 Sistemet e kontrollit të brendshëm	Adresimin e rekomandimeve të dhëna nga auditimet e mëhershme dhe forcimin e sistemit të kontrollit të brendshëm përmes mbikëqyrjes së gjithë proceduarave, që identifikojnë dobësitë më herët.			X
VII.2 Auditimi i brendshëm	Që NJAB gjatë auditimit të përfshijë fushat që paraqesin rrezik më të lartë në mënyrë që ti ndihmojnë dhe shtojnë vlerë menaxhimit të organizatës.		X	

Shtojca III. Komentet e MTI-së dhe përgjigja e ZAP-it

Menaxhmentit të MTI-së i është dhënë mundësia për të dhënë komente mbi draftin e këtij raporti. Çështjet e papërfunduara, për të cilat ne si auditorë dhe subjekti i audituar ende kemi pikëpamje të ndryshme, janë si më poshtë:

Kapitujt e raportit	Pajtohemi	Pajtohemi pjesërisht	Nuk pajtohem i	Komentet e MTI-së	Komentet e ZAP-it
6.1. Te hyrat Subjekti afarist i cili aplikon për licencë nuk kishte të sjellë dëshminë se ka përmbushur tërësisht obligimet ndaj institucioneve shtetërore siç janë taksat, tatimet dhe detyrimet tjera.			X	Një prej dokumentacioneve të kërkuara është vërtetimi nga Administrata Tatimore e Kosovës (ATK) që pala ka përmbushur obligimet . Ne rasti konkret, ne licencën nr.1540, pala ka prezantuar vërtetimin nga ATK se pala ka borxhe ndaj ATK-së por është ne marrëveshje për te paguar me këste . Ne kësë raste komisioni i brendshëm pranon këtë lloj vërtetimi si te mjaftueshëm pasi që pala është ne marrëveshje me ATK-në.	Ne nuk e ndajmë interpretimin e bërë nga Ministria rreth dhënies së licencave. Sipas mendimit tonë licencat nuk duhet të jepen kur obligimet ndaj ATK-së nuk janë të përmbushura.

6.2.2. Prokurimi Pranimi teknik nuk ishte në pajtueshmëri të plotë me kushtet e kontratave Kontrata për Ndërtimin e Laboratorit të Industrisë Kimike ishte në shumë (përfshire edhe aneks kontratën) prej 2,047,212€. Nga kjo shume ishin paguar 2,033,473€, mangësitë e identifikuar ishin si në vijim: Në raportin e Komisionit për pranimin teknik të datës 14.12.2011 nuk janë përshkruar të gjitha mangësitë për punët e pakryera. Në raport ishin prezantuar si punë të pakryera vetëm kycja në rrjetin e ujësjellësit dhe kycja në rrjetin elektrik që ishin në shumë 13,739€. Ne kemi identifikuar edhe çështje tjera që nuk ishin përshkruar ne raportin e komisionit për pranim teknik siç janë: kulmi dhe pllafonet e		X	Punët ne laboratorin e industrise kimike janë përfunduar , pastaj eshte bere pranimi teknik i objektit me përjashtim të kycje se ujit ne rrjetin elektrik. MTI kishte angazhuar kompanin për pranim teknik te objektit - Laboratorin e Industrise kimike. Kompanija e cila ka fituar tenderin ka përgatitur raportin me vërejtje. Vërejtjet e dhena nga operatori per pranim teknik janë, punëkryesi i ka eliminue. Kompania per pranim teknik ka hartue raportin përfundimtarë se vërejtjet e dhena janë përfunduar me përjashtim te : Kycjes së ujit dhe rrymes. Sa i përket rrjedhjes se ujit ne tavane , bora e cila ka ra, gypat nuk kanë mundur me përcjellur ujin dhe eshte formuar akulli dhe janë mbyllur gypat, dhe si shkas ka ardhë deri te rrjedhja ujit në pllafone. Ne momentin	Ekipa e auditimit ka vizituar objektin ku ka qene prezent edhe menaxheri i projektit me daten 02.03.2012 ku kemi vërejtur se kulmi dhe plafonet e tavaneve kishin lëshuar ujin dhe punimet e sipërfaqeve të rrugëve, shesheve dhe stazave nuk ishin vendosur ashtu siq është kërkuar në paramasë dhe paralogarit të tenderit ndërsa pagesat ishin bërë për punët që nuk ishin kryer konforme kushteve të kontraktuara .
---	--	---	---	--

tavaneve kishin lëshuar ujin dhe ishin dëmtuar si pasoje e dobësive të ndërtimit. Punimet e sipërfaqeve të rrugëve, shesheve dhe stazave nuk ishin vendosur ashtu siç janë kërkuar në paramasë dhe paralogari të tenderit. Në kontratën nënshkruar me datën 09.11.2009 (përfshirë edhe aneks kontratën) "Ndërtimi i Qendrës së Panairëve" në Bernicë të poshtme në shume totale 4,047,365€, nga të cilat 4,015,978€ ishin paguar deri me datën 22.12.2011. Krahas vonesave të theksuara në zbatimin e kësaj kontrate janë identifikuar edhe mangësi si ne vijim: Komisioni për pranim teknik dhe organi mbikëqyrës nuk kishin prezantuar në raport të gjitha punë e pakryera. Si punë të papërfunduara kishin paraqitur vetëm punët e gjelbërimit dhe dekorimit të kopshtit në shumë 16,448€.			ne kemi vërejtur se pllakat janë dëmtuar nga shtresa e borës se madhe që ka ra. Ne kemi ftuar kompaninë pergjegjese që te beje ri rregullimin e ketyre demeve që jane shkaktuar nga uji. Pllakat e dëmtuara jane evituar dhe jane vendos pllakat e reja ne pllafon. Pranimi teknik i objektit nuk ishte ne pajtueshmëri me kushtet e kontratave. Sa i perket puneve te kryera në Qendrën e Panairëve të Kosovës, raporti nga D. I Tregtise eshte përgatitur ne baze te raportit te pranimit teknik, kompani keto të përzgjedhura në bazë të ofertave per tenderim ne MTI. Për shkak te acarit të madhe ne objekt janë shkaktuar disa deme te cilat i ka sanuar punë kryesi, kjo do të thote se edhe pjesa e	Ekipa e auditimit me datën 02.03.2012 në prezencë të menaxherit të projektit për objektin e QPK ka dale në teren ku ka vërejtur se punimet ishin në proces por të papërfunduara në tërësi e që nuk ishin përfshirë në raportin e pranimit teknik si punë të papërfunduara e që i kemi prezantuar në këtë raport. ndërsa pagesat ishin bërë për punët që nuk ishin
--	--	--	---	--

					dysheimes jane kryer te gjitha punet pra edhe ato qe kane te bejne me shtresen e fundit të dysheimes ,shtres e lenget, e cila poashtu pat mbetur pa u përfunduar per shkak te ftohtit të madhë.	kryer konforme kushteve të kontraktuara . Andaj të gjeturat dhe rekomandimet e ZAP mbesin të pandryshuara.
7.2 Sistemi i kontrollit të brendshëm MTI nuk kishte zbatuar kriteret e ligjit për shërbimin civil për pozitë si ushtrues detyre, sipas të cilit ushtruesi i detyrës nuk mund të emërohet në afat më gjatë se tre (3) muaj.				X	2. Ndërsa sa i përket ushtruesit të detyrës së drejtorit për rezerva është vepruar konform ligjit për shërbimin civil sepse i njëjti nuk ka ushtruar kete detyre as 90 dite do të thotë në pajtim me dispozitat ligjore në fuqi ,U.D. ka te drejt ne ushtrimin e detyrave të punës 3 muaj. Andaj çdo veprim është konforme dispozitave ligjore në fuqi .	Sipas vendimit nr.02 ref.52/06-2011, U.D i drejtorit të departamentit për rezervat shtetërore të mallrave në kuadër të MTI-së ishte caktuar me datën 08.06.2011 dhe ai kishte ushtruar kete detyr deri me datën 20.01.2012, me gjate se 90 ditë . Andaj të gjeturat dhe rekomandimet mbesin të pandryshuara.

Më tutje, Menaxhmenti i MTI-së është zotuar që do të bëjnë të gjitha përpjekjet për ti adresuar të gjitha rekomandimet e dhëna.